



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 Janar 2012
Ref. No.: TK 194/12

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin Nr. KI 14/10 dhe Rastin Nr. KI 15/10

Besnik Musa dhe Hekuran Muhaxhiri

kundër

Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

dhe

Ministrisë së Drejtësisë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit

1. Parashtrues janë z. Besnik Musa dhe z. Hekuran Muhaxhiri me banim në Gjakovë. Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese ata përfaqësohen nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

- Rastet në fjalë janë të ngjashme me Rastin KI 06/10 “Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë”. Në këtë rast, Gjykata vendosi që ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për liri të lëvizjes, të garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, Gjykata ka vendosur që praktika e bazuar në memorandumun e mirëkuptimit, të 21 gushtit 2008, e zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale, e pengoi parashtruesin që ta gëzonte të drejtën e tij për mjet efektiv juridik në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese konstatoi që Ministria e Punëve të Brendshme duhej të vendoste lidhur me kërkesën e parashtruesit për pasaportë, të 27 prillit 2009, në pajtim me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit brenda 30 ditësh pas pranimin të këtij Aktgjykimi (*Shih Aktgjykimin KI 06/10, të 30 tetorit 2010*).

Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të lirisë së lëvizjes së parashtruesve, të garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Sipas parashtruesve të kërkesës, atyre u është shkelur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi u është refuzuar lëshimi i pasaportës, e cila kërkohet për të udhëtuar jashtë vendit. Parashtruesit më tej pohuan që në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mjete efektive juridike për ta ushtruar të drejtën e tyre për t'u larguar nga vendi.
- Parashtruesit kanë paraqitur kërkesë për masa të përkohshme, përmes përfaqësuesit të tyre, për ta shmangur “diskriminimin e mëtejme dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër.”

Baza juridike

- Këto kërkesa janë të bazuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Përmbledhja e fakteve

- Parashtruesit i mbështesin kërkesat e tyre vetëm duke iu referuar dokumenteve të përmendura në kërkesën e parashtruar në Gjykatë.

Ankesat e parashtruesve të kërkesës

- Parashtruesit ankohen se u është shkelur e drejta e tyre për liri të lëvizjes e garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës. Ata pohojnë që Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të padrejtë dhe të gabueshme i ka interpretuar dispozitat e zbatueshme ligjore pasi ka dështuar t'ua lëshonte certifikatën, e cila, siç pohohet, është dokument i domosdoshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme për të lëshuar pasaportë të Republikës së Kosovës.
- Parashtruesit, gjithashtu ankohen se në Kosovë nuk ka mjete juridike që mund të përdoren për ta zgjidhur situatën e tyre. Prandaj, sipas tyre, ekziston nevoja për krijimin e një mekanizmi brenda shtetit për qytetarët e Kosovës që janë në të njëjtën situatë si ata për ta parandaluar shkeljen e mëtejme të së drejtës për lëshim të pasaportës.

9. Parashtruesit pohojnë që u është shkelur e drejta për liri të lëvizjes për shkak të zbatimit të gabuar të nenit 271(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nenit 27.1, pika A, dhe nenit 28.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Sipas parashtruesve, të dy ligjet parashikojnë që kufizimi i të drejtës për liri të lëvizjes, i shkaktuar nga refuzimi për lëshim të pasaportës, mund të vendoset vetëm për rastet në të cilat gjykata kompetente ka lëshuar vendim paraprak.
10. Parashtruesit, gjithashtu pohojnë që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kurrfarë baze juridike për t'ua privuar të drejtën e tyre kushtetuese në bazë të mungesës së certifikatës së lëshuar nga gjykata që një person nuk është nën hetime. Në parim, sipas tyre, kufizimi i vendosur në të drejtën e tyre për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe e praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumit të mirëkuptimit, të 21 gushtit 2008, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.
11. Në fund, parashtruesit kërkuan caktimin e masës së përkohshme “për ta shmangur diskriminimin e mëtejshëm dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër”.

Përmbledhja e procedurës në Gjykatë

12. Parashtruesit i parashtruan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese më 5 shkurt 2010.
13. Më 19 shkurt 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 06/10, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 06/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
14. Më 25 mars 2011, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI 06/10, të 30 tetorit 2010, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesit që ta njoftonin Gjykatën Kushtetuese nëse i kanë marrë pasaportat.
15. Më 6 prill 2011, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI 06/10, parashtruesve u ishin lëshuar pasaportat.
16. Parashtruesit e njoftuan Gjykatën Kushtetuese se kërkesa e tyre ishte realizuar.
17. Më 16 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për heqje të kërkesës nga lista.

Vlerësimi i Gjykatës

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara në rregullin 32 të Rregullores së punës.
19. Rregulli 32 i Rregullores së punës, në pjesën përkatëse, thotë me sa vijon:

1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë në lidhje me të.

(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, përgjigjet e parashtruara dhe gfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj.

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

20. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës ndërpritet dhe Gjykata konstaton që nuk ka rrethana të posaçme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës (shih *mutatis mutandis*, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Rafet Hoxha KI 24/09, të 24 marsit 2010).


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS


- I. TA HEQË kërkesën nga lista.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani